



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 01/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Dokumenti "Takimi i Dytë Kosovë-BE i Këshillit të Stabilizim-Asocimit".
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/14  
Datë: 15.11.2017


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Grupi i Punës për hartimin e Koncept Dokumentit për Programin për Zvogëlimin e Barrës Administrative, në këtë përbërje:

1.1. Drejtori i SKQ-së/ZKM	kryesues;
1.2. Drejtori i ZL-së/ZKM	zv. kryesues;
1.3. Këshilltar i Kryeministrit	1 anëtar;
1.4. Këshilltarë të Zëvendëskryeministrave	5 anëtarë;
1.5. Sekretariati Koordinues i Qeverisë/ZKM	2 anëtarë;
1.6. Zyra Ligjore/ZKM	1 anëtar;
1.7. Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM	1 anëtar;
1.8. Zyra për Komunikim me Publikun/ZKM	1 anëtar;
1.9. Zyra për Buxhet dhe Financa/ZKM	1 anëtar;
1.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës/ZKM	1 anëtar;
1.11. Zyra Ligjore/MTI	1 anëtar;
1.12. Agjencia për Promovimin e Investimeve/MTI	1 anëtar;
1.13. Zyra Ligjore/MAP	1 anëtar;
1.14. Zyra Ligjore/MIE	1 anëtar;
1.15. Departamenti i Makros/MF	1 anëtar;
1.16. Oda Ekonomike e Kosovës	1 anëtar;
2. Sekretariati Koordinues i Qeverisë është përgjegjës për të udhëhequr dhe koordinuar procesin e hartimit të Koncept Dokumentit, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit.
3. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, si dhe persona tjerë.
4. Grupi punues do të përkrahët nga projekti i SIDA-s në ZKM, me përbërje prej katër anëtarësh.

5. Grupi punues është i obliguar që për punën e tij t'i raportojë Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Grupit punues, si dhe obligohet që Koncept Dokumentin t'ia paraqesë Qeverisë për miratim në vitin 2018.
6. Grupi punues obligohet që Koncept Dokumentin ta hartojë në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë nr. 09/2011, dhe Udhëzuesin përkatës për hartimin e koncept dokumenteve.
7. Zyra e Kryeministrit obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e Grupit punues.
8. Obligohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre, që të ofrojnë bashkëpunimin e tyre për Grupin punues.
9. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 04/14

Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 159,000 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) euro, për nevojat e Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pagesën e qirasë si dhe materialit për ngrohje të objektit Prokuroria Themelore në Mitrovicë (përmbushja e obligimit nga Marrëveshja e Brukselit).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen tek Këshilli Prokurorial i Kosovës, nën programi Prokuroritë dhe Administrata me kod 33500, kategoria e shpenzimeve mallrat dhe shërbimet, nën kategoria ekonomike qiraja për ndërtesa me kod 14110 në shumë prej 144,000 (njëqind e katërdhjetë e katër mijë) euro, si dhe nën kategoria ekonomike për dru (material për ngrohje) me kod 13760 në shumë prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.
3. Obligohet Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 05/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 40 paragrafi 2. të Rregullores (QRK) nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.10/2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Sekretaria e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, në këtë përbërje:
  - 1.1. Labinot Bala, psikolog anëtar;
  - 1.2. Mire Prenaj, punëtore psikosociale anëtare;
  - 1.3. Habibe Nuha, juriste anëtare;
2. Mandati i anëtarëve të sekretarisë sipas pikës 1. të këtij vendimi është deri sa të zgjasë mandati i Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, i themeluar me vendimin nr. 06/143 të datës 28.04.2017.
3. Sekretaria për punën e vet i përgjigjet kryetarit të Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarisë janë ofrimi dhe mbështetja administrative e Komisionit sipas përshkrimit të punëve të përcaktuara nga Komisioni dhe sipas Rregullores (QRK) nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.10/2016.
5. Anëtarët për punën dhe angazhimin e tyre në sekretari, do të paguhën me pagë mujore sipas koeficientit 8 (tetë), pagë bruto në vlerë prej 494.75 €.
6. Anëtarët e sekretarisë janë të obliguar t'i nënshtrohen trajnimit të përcaktuar sipas Rregullores (QRK) nr. 22/2015.

7. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe të gjitha instutucionet tjera që janë të përfshira sipas legjislacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 014/2016, i datës 15.03.2016.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramuŝ HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Pensioni i Personave të dhunuar gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës, është 230 (dyqind e tridhjetë) euro.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Vendimimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramuš HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë






**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19 paragrafi 5. të Ligjit nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 2315 dhe 3146, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni i veçantë i shkallës së dytë i Qeverisë (Komisioni i Ankesave) për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e aplikuesve të pakënaqur me vendimet e Komisionit për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë.
2. Komisioni i Ankesave do të ketë këtë përbërje:
  - 1.1. Fatlik Lila - Avokat, ish i dënuar politik;
  - 1.2. Binak Ulaj - ish i dënuar politik;
  - 1.3. Nijazi Korça - ish i dënuar politik;
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Komisioni i Ankesave, Komisioni për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë, si dhe institucionet tjera kompetente.
3. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 10/100 i datës 15.07.2016.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/14

Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 12. të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (Gazeta Zyrtare nr. 30/31.12.2011), i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre (Gazeta Zyrtare nr. 26/23 prill 2014), të nenit 4 paragrafi 1. dhe neni 46 të Rregullores (QRK) nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 10/2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 06/143 të datës 28.04.2017**

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/A si në vijim:

3/A. Kryetarja dhe anëtarët e Komisionit për punën dhe angazhimin në Komisionin për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, kompensohen si vijon:

1.1. Kryetarja e komisionit kompensohet në shumën prej 300 (treqind) euro në muaj;

1.2. Anëtarët e komisionit kompensohen në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro në muaj.

2. Kompensimi i anëtarëve bëhet në mënyrë retroaktive nga data e emërimit të Komisionit me vendim të Qeverisë nr. 06/143 të datës 28.04.2017.

3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/14

Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Kompensohen fermerët vendorë për dëmin e pësuar me rastin e ngordhjes së kafshëve-gjedheve nga sëmundja Gungore e Lëkurës (SGL/LSD), gjatë vitit 2016.
2. Kompensimi i fermerëve për krerë gjedhe-kafshë të ngordhura të bëhet, bazuar në vlerësimin e përcaktuar nga Komisioni i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), të ndara sipas kategorive në vijim:
  - 2.1. Lopët - 1200€, për krerë;
  - 2.2. Viçat - 500 €, për krerë;
  - 2.3. Demat/mështjerrat - 800€, për krerë.
3. Mjetet financiare për kompensimin e këtyre fermerëve janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, i ndarë për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.
4. Këtij vendimi i bashkëngjitet raporti i komisionit të AUV-së me numrin e kafshëve të ngordhura, të ndara sipas kategorive nëpër komuna dhe ndarja e kafshëve të ngordhura sipas kategorisë së vlerësimit.
5. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-125 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 10/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në kontekst të aderimit në Bashkimin Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HADRI**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekst të aderimit në Bashkimin Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

**Nr. 12/14**  
**Datë: 15.11.2017**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Leposaviqit për Zyrën Lokale për Komunitete për ndarjen e mjeteve financiare në kategorinë e shpenzimeve kapitale, linja buxhetore 10/641/19605/31690/Projekt i Ri/1090 - "Furnizim me inventar dhe pajisje", shuma prej 26,673.90 euro, si dhe linja buxhetore 10/641/19605/31126/Projekt i Ri/1090 - "Rrethoja e Objektivit" shuma prej 10,040 euro.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve kapitale, nën kategoria ekonomike ndërtesat e banimit me kod 31110.
3. Obligohet Komuna e Leposaviqit/Zyra Lokale për Komunitete dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/14  
Datë: 15.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për pezullimin dhe largimin nga detyra të zyrtarëve publikë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë